



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:185152
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05460779

Ac.nr.7420/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Civil, gjyqtari individual Ylber Shurdhiqi, në çështjen juridike–përmbartimore të kreditorit Sh.a KUR ”M”, me seli në Mitrovicë, Rruga “B B”, p.n, kundër debitorit B B nga Vushtrria, Rruga, ”X.J”, lidhur me çështjen përmbartimore, për borxh, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, CPP.nr.235/21, të datës 24.06.2022, me datë 15.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e kreditorit Sh.a KUR ”M”, me seli në Mitrovicë, Rruga “B B”, p.n, PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, CPP.nr.235/21, të datës 24.06.2022, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar CPP.nr.235/21, të datës 24.06.2022, e ka aprovuar pjesërisht kundërshtimin e debitorit B B nga Vushtrria, ashtu që e ka shfuqizuar pjesërisht Urdhri për Lejimin e Përmbartimit P.nr.762/21 i datës 29.04.2021 dhe e ka obliguar debitorin Bajram Begu, që në emër të borxhit për konsumin e ujit dhe shërbimeve të kanalizimit, kreditorit t’ia paguaj shumën prej 8.11 € (tetë euro e njëmbëdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga data e paraqitjes së propozimit për përmbartim me datën 29.04.2021 e deri në pagesën definitive të borxhit, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës së kreditorit për periudhën kohore nga 31.03.2016 e deri me 31.12.2019, përtej shumës që është obliguar debitori si në dispozitiv të këtij aktvendimi, është refuzuar si e pa bazuar.

Kundër këtij aktvendimi kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që aktvendimi i ankimuar të anulohet ashtu që të aprovohet ankesa e kreditorit si e bazuar dhe vendimi i atakuar të ndryshohet.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, ka gjetur se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Kreditori, me datë 24.09.2021 ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit kundër debitorit, për pagesën e borxhit në emër të shpenzimit të ujit dhe shërbimeve të kanalizimit në shumën prej 528.97 € (pesëqind e njëzetë e tetë euro e nëntëdhjetë e shtatë cent). Përmbartuesi Privat me urdhrin P.nr.762/21 të datës 29.04.2021 e ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit.

Kundër këtij urdhri mbi lejimin e përmbartimit, Debitori në afat ligjor ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin e Përmbartuesit Privat, duke e kundërshtuar në tërësi borxhin e kreditorit, me arsyetimin se borxhi është i parashkruar konform nenit 360 të LMD-së, duke propozuar aprovimin e prapësimit dhe anulimin e urdhrin për lejimin e përmbartimit.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në kundërshtimin e debitorit, duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit në kundërshtimin e ushtruar dhe duke i propozuar gjykatës që kundërshtimin e debitorit ta hedhë poshtë si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin e ankimuar CPP.nr.235/21, të datës 24.06.2022, e ka aprovuar pjesërisht kundërshtimin e debitorit, ashtu që e ka shfuqizuar pjesërisht Urdhri për Lejimin e Përmbartimit P.nr.762/21 i datës 29.04.2021 dhe e ka obliguar debitorin, që në emër të borxhit për konsumin e ujit dhe shërbimeve të kanalizimit, kreditorit t'ia paguaj shumën prej 8.11 € (tetë euro e njëmbëdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga data e paraqitjes së propozimit për përmbartim me datën 29.04.2021 e deri në pagesën definitive të borxhit, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës së kreditorit për periudhën kohore nga 31.03.2016 e deri me 31.12.2019, përtej shumës që është obliguar debitori si në dispozitiv të këtij aktvendimi, është refuzuar si e pa bazuar, duke vendosur më saktësisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se Gjykata, se kundërshtimi i debitorit, është pjesërisht i bazuar sa i përket borxhit të kreditorit të pretenduar në raport me debitorin, për faktin se borxhi i krijuar nga debitori deri me datë 31.12.2019 është parashkruar, konform nenit 360, par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, ku përcaktohet se "*Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti*", ndërsa në nenin 360 par.1, nënpar.1.1, të këtij ligji përcaktohet se "*kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake*", ndërsa sa i përket rrjedhjes së afatit të parashkrimit, në nenin 360, par.2 të të njëjtit ligj përcaktohet se "*Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë*". Në rastin konkret pasi që kreditori propozimin për përmbartim e ka parashtruar në vitin 2021 dhe e ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit nga data 01.01.2020 e deri në kohën e parashkrimit të propozimit, ashtu që borxhi të cilin duhet ta paguaj debitori si në pikën I të dispozitivit është 8.11 euro, i cili është krijuar nga 01.01.2020 e deri në parashkrimin e propozimit për përmbartim

29.04.2021, e që duhet të paguhet nga debitori, ngase gjen mbështetje në nenin 8 të LMD-së, ku përcaktohet se *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”*, dhe në nenin 245 par.1 të LMD-së, ku përcaktohet se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij, Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve të pjesëmarrësve në marrëdhënien e detyrimeve ose në bazë të ligjit”*.

Po ashtu, ka shtuar se meqenëse u konstatua se gjatë kësaj periudhe nuk ka prova se palët kane lidhur marrëveshje për riprogramim të borxhit që do të shkaktonte ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit dhe nuk ka prova se kreditori ka ndërmarrë ndonjë veprim ligjor kundër borxhit të debitorit që do të shkaktonte ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit për periudhën gjegjëse kohore, gjykata iu referua aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev.nr. 148/2012, të datës 09.09.2013 (faqja 3, pasuesi i katërt i aktgjykimit), ku parashihet se pagesat eventuale që janë bërë për këtë periudhë nga debitori në formë të ndonjë pagese në këste nuk shkaktojnë ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, po që se ato nuk i referohen ndonjë pagese të ndonjë fature fikse për muajin gjegjës, përveç nëse mes palëve ka marrëveshje për riprogramim të borxhit apo ka specifikime të kërkesës për të cilën behet pagesa që në rastin konkret nuk ekzistojnë, e të cilat konform nenit 368, par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, do të rezultojnë me ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit për debitorin.

Pagesat e kohëpaskohshme që debitori ka paguar në emër të borxhit si tërësi nuk nënkupton pohim i borxhit për vet faktin se i njëjti me prapësimin e ushtruar ka kundërshtuar në tërësi borxhin e të njëjtit pagesa nuk janë këste të paguara mbi bazën e ndonjë marrëveshje, ashtu që këto pagesa paushallë nuk kanë shkaktuar ndërprerjen e afatit të parashkrimit për debitorin në rastin konkret. Pohim indirekt të borxhit sipas vlerësimit të kësaj gjykate kemi atëherë kur debitori hynë në marrëveshje riprogramimi me kreditorin dhe përcakton afate të reja kohore dhe periudha në këste të caktuara për përmbushjen e borxhit në tërësi.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sipas aktvendimit të ankimuar, Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë si të rregullt dhe të ligjshëm, për shkak se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5, të Ligjit të Procedurës Kontestimore, si dhe lidhur me nenin 4, 17, 29 dhe 73 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk i është përmbajtur dispozitave të cituara për arsyetimin e aktvendimit sepse nuk ka paraqitur në mënyrë të strukturuar dhe të kuptueshme cilat kanë qenë kërkesat e palëve respektivisht kundërshtimet, cilat kanë qenë faktet vendimtare, cilat prova janë shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe si janë vlerësuar ato dhe si pasojë ka dështuar të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Me nenin 29 paragraf 1, pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: Dokument i besueshëm sipas këtij ligji, janë ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”. Në këtë rast në shkresat e lëndës si prova materiale gjendet ekstrakti nga librat afariste Kartela e konsumuarit për datën 2016-

2021, ndërsa nga raporti i llogarisë për konsumatorin llogaritet qarkullimi për periudhën raportuese nga data 01.01.2013 deri me datë 20.05.2021.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me vlerësim jo të plotë dhe të gabuar të fakteve të çështjes, ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat ligjore të LPP-së dhe LMD-së për arsye se në këtë rast gjykata e shkallës së parë, nuk ka arsyetuar faktet vendimtare sa i përket periudhës kohore, përkatësisht se për cilën periudhë kohore kërkohet përmbushja e detyrimit nga ana e debitorit, sa ka qenë ajo shumë, a ka paguar debitori borxhin për atë periudhë kohore, a e ka pranuar borxhin kreditori, dhe a ka pasur marrëveshje për programim të borxhit ndërmjet kreditorit dhe debitorit, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Po ashtu sa i përket parashkrimit gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë një arsyetim lidhur me parashkrimin, dhe për gjykatën e shkallës së dytë nuk mund të kuptohet se si ka ardhur deri te një vendosje e tillë lidhur me parashkrimin, pasi debitori në prapësimin e paraqitur është thirrur në institutin e parashkrimit duke theksuar se borxhi është vjetërsuar, andaj në këtë rast me vet faktin e mos përcaktimit të periudhës kohore brenda të cilës është kërkuar përmbushja e detyrimit nënkupton faktin tjetër edhe mos mundësinë e llogaritjes së parashkrimit të kërkesës si pretendim i palës debitore.

Të gjeturat dhe konstatimet e bëra si më lartë nga gjykata ankimore, aktvendimin e ankimuar e bëjnë jo të drejtë dhe pa mbështetje në ligj, andaj ka qenë e domosdoshme që të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe vendosje.

Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura, të konstatoj se për cilën periudhë kohore konkretisht kërkohet përmbushja e detyrimit, sa ka qenë ai detyrim dhe a është paguar për atë periudhë kohore, a ka pasur riprogramim të borxhit, pastaj të bëjë vlerësimin sa i përket parashkrimit të kërkesës duke marr për bazë të gjeturat e Gjykatë së Apelit, e në përputhje me natyrën e kërkesës dhe dispozitat materiale, të cilat i referohen parashkrimit të kërkesave për bazë të njëjtë, si çështje objekt i përmbartimit, duke pasur parasysh gjithashtu që me rastin e vendosjes meritorie, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitoj shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që dhe gjykata e shkallës së parë në rastin konkret duhet që propozimin për përmbartim t'ia kthej kreditorit në plotësim konform nenit 102 të LPK-së, në mënyrë që të përcaktohet nga kreditori periudha kohore për të cilën kërkohet përmbartimi, e pastaj gjykata të vlerësoj parashkrimin sipas propozimit për përmbartim.

Mbi bazën e shkeljeve të konstatuara si më lartë, kjo gjykatë gjeti se aktvendimi i ankimuar duhet prishur dhe çështja duhet kthyer në rivendosje tek gjykata e shkallës së parë, pasi që në rastin konkret nuk ka pasur kushte që i njëjti aktvendim të mund të ndryshohej nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbartimore *”në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Numri i lëndës: 2021:185152
Datë: 15.03.2024
Numri i dokumentit: 05460779

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (d) të LPK, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PPISHTINË

Ac.nr.7420/2022, datë 15.03.2024

G j y q t a r i,
Ylber Shurdhiqi